



Prishtinë: 05.08.2010

Kodi i ZRRE-së: V_259_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_V_418_06_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_418_06_10** ;
5. Apeli i konsumatorit me datë 16.07.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë; dhe
7. Ligjin për Radio Televizionin e Kosovës Nr. 02/L-47

Në mbledhjen e mbajtur më 05 gusht 2010 nxori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa e konsumatorit Fitim Vertopi (shifra e konsumatorit DPR – 4129) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura të këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së me datë 26.04.2010 ka apeluar përgjigjet e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 03.11.2009, lidhur me kontestimin për parapagimin për RTK.

- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar parapagimin për RTK.
Provë: Dëftesa e ankesës në KEK
- Me datë 03.11.2009 Departamenti për Konsumator iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar e duke u thirrur në Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2003/12.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 30.11.2009

- Me datë 26.04.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së.
- Me datë 01.06.2010 DMK e ZRRE-së ka nxjerrë vendim në lidhje me ankesën e konsumatorit duke e refuzuar ankesën e konsumatorit në arsyetimin se konsumatori nuk ka plotësuar asnjë kriter të paraqitur në nenin 20.3 dhe 20.9 të Ligjit Nr. 02/L-47 të Radio Televizionit të Kosovës.
Provë: Vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_418_06_10
- Me datë 16.07.2010 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, duke kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_418_06_10.
Provë: Ankesa e konsumatorit në Bord të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: ZRRE/DMK_V_418_06_10 dhe ka konstatuar se vendimi është në pajtim me Rregullat e ZRRE-së. Apeluesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi shtesë kundër këtij Vendimi, andaj Bordi i ZRRE-së ka vendosur ta **refuzojë** konsumatorin për arsyet e paraqitura në vendimin e DMK të ZRRE-së dhe vendimi i DMK-së nr. ZRRE/DMK_V_418_06_10 mbetet në fuqi.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar